



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 1963 prot.

Tiranë, më 13.07.2026

REKOMANDIM

Nr. 36, datë 13.07.2026

**MBI ZBATIMIN E LIGJIT NR. 33/2022 “PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE
RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT TË SEKTORIT PUBLIK”
NGA AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve të organeve të sektorit publik, referuar nenit 19, pika 1 e ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” (në vijim “Ligji nr. 33/2022”).

Në zbatim të “Planit të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” nga organet e sektorit publik”, për vitin 2026, publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit, si dhe Urdhrit nr. 53, datë 11.03.2026 “Për miratimin e “Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike””, u krye procesi i monitorimit, me objekt:

- ❖ Monitorim online i faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në link-un <https://akm.gov.al/>, lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” e aktet nënligjore në zbatim të tij.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e monitorimit online nga struktura përgjegjëse dhe provat e administruara gjatë këtij procesi monitorimi, vëren se:

- Ligji nr. 33/2022, në nenin 3 “Fusha e zbatimit”, shkronja “a”, përcakton se: “Ky ligj zbatohet për ripërdorimin e: a) dokumenteve ekzistuese që mbahen nga organet e sektorit publik;”

Në pikën 9 të nenit 6 të ligjit nr. 33/2022 përcaktohet se: “Organet e sektorit publik” përfshin çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative; çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdolloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.”

Për sa më sipër, në kuptim të ligjit nr. 33/2022, Agjencia Kombëtare e Mjedisit konsiderohet Organ i Sektorit Publik dhe duhet të zbatojë detyrimet ligjore sipas dispozitave të mëposhtme të këtij ligji:

- Sipas nenit 6, pika 15: “Të dhëna të hapura” është format i pavarur nga platforma, i vënë në dispozicion të publikut pa asnjë kufizim që pengon ripërdorimin e dokumenteve.”
- Sipas nenit 7, pika 3: “Organi i sektorit publik përcakton listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e bën publike.”
- Sipas nenit 9, pika 4” “Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, për aq sa është e mundur teknikisht, i bëjnë të disponueshme të dhënat për ripërdorim menjëherë pas mbledhjes, përmes ndërfaqeve të përshtatshme API, në formë dinamike ose kur është e përshtatshme, si një shkarkim i vetëm voluminoz (bulk download).”
- Sipas nenit 10, pikat 1, 2 dhe 5:
 - “1. Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, ofrohet pa pagesë.
 - 2. Ripërdorimi i dokumenteve mund të bëhet kundrejt një tarife për të mbuluar kostot shtesë për arsye të riprodhimit, ofrimit e shpërndarjes së dokumenteve, për anonimizimin e të dhënave personale, si dhe për masat e marra për të mbrojtur informacionin sekret tregtar.
 - 5. Për çdo rast ku aplikohet tarifa, metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organi i sektorit publik që aplikon tarifa për të drejtën e ripërdorimit e bën atë publike në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura.”
- Sipas nenit 11, pika 2: “Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur ose kundrejt aplikimit të licencës standarde. Në rastin e aplikimit të licencës standarde, licenca ofrohet në formatin elektronik sipas modelit të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”

- Sipas nenit 12, pika 1: *“Me qëllim lehtësimin e kërimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, krijohet/funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare. Ky portal krijohet dhe administrohet nga AKSHI.”*

Në interpretim të këtij neni, organet e sektorit publik duhet të mundësojnë ndërveprimin me portalin e të dhënave të hapura qeveritare opendata.gov.al.

- Sipas nenit 16, pika 1: *“Në grupin e të dhënave me vlerë të madhe përfshihen të dhëna në fushat:*
b) mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës;
.....”

- Sipas nenit 17, pikat 1 dhe 2:

1. *“Për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe për ekonominë dhe shoqërinë nga organi/et publike përgjegjëse, në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcaktohen grupet specifike të këtyre të dhënave.*
2. *Grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe duhet të jenë:*
 - a) të disponueshme pa pagesë;*
 - b) të lexueshme nga kompjuteri;*
 - c) të ofruara përmes API-ve; dhe*
 - ç) kur është me rëndësi, të ofruara si një shkarkim i vetëm.”*

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe i Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 2, datë 6.2.2025 *“Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”*, përcakton këto detyrime kryesore për organet e sektorit publik:

- ✓ Sipas Kreut II, Fusha e Zbatimit, shkronja “a”: *“Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, për ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese që mbahen prej tyre, në kuadër të detyrës publike.”*
- ✓ Sipas Kreut III, pika 2: *“Licenca do të jetë në format elektronik dhe do të shoqërojë informacionin që do të publikohet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al.”*
- ✓ Sipas pikës 5: *“Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lidhur me implementimin e licencave në formatin elektronik, për dokumentet në formatin e të dhënave të hapura, në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al, ripërdorimi i të cilave kërkon aplikimin e licencës standarde.”*
- ✓ Sipas Kreut V, pika 2: *“Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.”*

Në përmbushje të këtyre përcaktimeve ligjore vlerësohet se Agjencia Kombëtare e Mjedisit luan një rol thelbësor në krijimin dhe publikimin e të dhënave në fushën e mjedisit, e cila është një kategori të rëndësishme e të dhënave me vlerë të madhe, referuar neneve 16 dhe 17 të ligjit nr. 33/2022.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim “AKM”) është institucion në varësi të Ministrisë së Mjedisit. Veprimtaria e agjencisë rregullohet me ligjin nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, e ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Mjedisit e shtrin veprimtarinë e saj jo vetëm në fushën e mjedisit (referuar ligjit nr. 10431/2011), por edhe në fushat e tjera si ajri, uji, biodiversiteti, për të cilat AKM-ja, referuar ligjeve specifike që rregullojnë këto fusha, duhet të mbledhë, përpunojë dhe publikojë të dhëna.

Referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi të sektorit publik, si dhe referuar ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, janë evidentuar dokumentet ekzistuese/të dhënat, që ky institucion duhet të publikojë në faqen zyrtare si të dhëna të hapura.

AKM-ja ka detyrimin ligjor për publikimin e dokumenteve dhe të dhënave publike që mban dhe prodhon referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni, në format të hapur (*open data*), të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me *metadata*-n, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 33/2022.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore të mësipërme dhe detyrimeve të ligjit nr. 33/2022, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin online të faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, konkretisht rubrikave dhe përmbajtjes së tyre bazuar në dimensionet e vlerësimit të këtij procesi të monitorimit online, referuar “Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike”.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të AKM-së, në link-un: <https://akm.gov.al/>, për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022, rezulton se:

1. Agjencia nuk ka krijuar një rubrikë të dedikuar për të dhënat e hapura dhe nuk ka publikuar një listë të dokumenteve që mban e prodhon, që mund të ofrohen në format të hapur, sikurse kërkohet nga neni 7, pika 3 e ligjit nr. 33/2022.
2. Në faqe, në menunë kryesore, ekzistojnë rubrika të cilat kanë të listuara në mënyrë të shpërndarë dokumente të ndryshme që duhet të publikohen referuar fushës së saj të përgjegjësisë.
3. Nga verifikimi i përmbajtjes së këtyre rubrikave konstatohet se ato përmbajnë informacion/listë lidhur me dokumentet/të dhënat që duhet të mbledhë/përpunojë/krijojë/prodhojë dhe publikojë kjo Agjenci referuar detyrimeve ligjore, sipas fushës së saj të përgjegjësisë. Nëse klikojmë mbi emërtesën e çdo dokumenti të listuar në këto rubrika konstatohet se ato ofrojnë informacion të publikuar të fragmentizuar e të papërditësuar.

4. Për sa i përket formatit të dokumenteve, rezulton se nuk janë në formate të hapura, të lexueshme nga kompjuteri, referuar detyrimeve ligjore që duhet të përmbushë ky organ i sektorit publik.

Lidhur me konstatimet e mësipërme, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 33/2022, më poshtë paraqitet situata konkrete pas verifikimit të përmbajtjes së rubrikave të publikuara në faqen zyrtare të AKM-së:

Në menunë kryesore janë listuar rubrikat e mëposhtme:

- Menuja “Ndikimi i Mjedisit” ka në përmbajtje nënmenutë:
 - ✓ *Leje Mjedisore* – gjejmë të publikuara dokumentet si më poshtë:
 - ✓ “Baza e të dhënave për licencat III.2.B, periudha janar 2012 – dhjetor 2022, janar 2022 – dhjetor 2023, janar 2024 – maj 2024”, në formatin *xlsx*;
 - ✓ *Vendimet e Komisioneve* për Leje Mjedisore për periudhën 15 mars 2013 – 24 korrik 2019, në formatin *xlsx*;
 - ✓ *Vlerësimi i ndikimit në mjedis* – janë publikuar: Vendimet e Komisionit të Shqyrtimit të Aplikimeve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për periudha të ndryshme. Dokumentet janë në formatin *xlsx*. (Rekomandohet që të përfshihen në një tabelë përmbledhëse e jo të publikohen tabela për çdo mbledhje);
 - ✓ *VNM Paraprake dhe Vendime VNM* – kanë të ngarkuara dokumente individuale të subjekteve, të skanuara. (Rekomandohet që të përfshihen në një tabelë përmbledhëse në format të hapur).
- Menuja “Publiku/Faturat” gjenden të publikuara: Baza e të dhënave për Lejet e Mjedisit Tipi A/B për periudhën janar 2014 – prill 2026, Baza e të dhënave për VNM-të për periudhën janar 2014 – prill 2026, Baza e të dhënave për licencat III.2.B për periudhën janar 2012 – prill 2026, në formatin *xlsx*.
- Menuja “Cilësia e Mjedisit” përfshin 3 nënrubrika:
 - ✓ *Raporte dhe Publikime*: Janë të publikuara dokumente “Buletini Mjedisor” për periudha të ndryshme me vite dhe Raporti për Gjendjen e Mjedisit ndër vite. Dokumentet janë në format *pdf*, jo në formate të hapura;
 - ✓ *Monitorime*: Janë publikuar të dhëna mbi monitorimin e lumenjve, liqeneve, bregdetit, nivelit të zhurmave etj., në fragmente-harta, të cilat nuk janë në formate të hapura;
 - ✓ *Akreditime dhe Certifikime*: Janë ngarkuar certifikata akreditimi individuale. E përshtatshme është të publikohen si lista me të dhënat e certifikatave, në formate të hapura.
- Menuja “Kimikatet” përfshin 3 nënrubrika:
 - ✓ *Mjedisi dhe Kimikatet*: Në këtë rubrikë ka një informacion narrativ mbi pesticidet dhe mjedisin. Nuk ka të dhëna mbi gjendjen lidhur me këtë rubrikë;
 - ✓ *Informacion*: Përmban informacion narrativ të përgjithshëm, pa të dhëna konkrete mbi situatën në vendin tonë;
 - ✓ *Biocidet*: Kjo rubrikë gjithashtu ka informacion narrativ me qëllim informim të përgjithshëm, pa të dhëna konkrete mbi situatën.

- Menuja “Informacione” përmban 2 nënrubrika të rëndësishme për publikim të dhënash:
 - ✓ *RRSHTN - Regjistri i Shkarkimeve të Ndotësve në Mjedis* – Nuk ka asnjë informacion;
 - ✓ *Statistika* – Nuk ka asnjë statistikë të publikuar.
- Menuja “ARM” përmban nënrubrikat e mëposhtme:
 - ✓ ARM Tiranë/Durrës/Dibër;
 - ✓ ARM Berat/Korçë/ Elbasan;
 - ✓ ARM Fier/Vlorë/Gjirokastrë;
 - ✓ ARM Lezhë/Shkodër/Kukës.

Këto nënrubrika kanë të njëjtën përmbajtje, nga verifikimi i të cilave rezulton si më poshtë:

- ✓ *Konsultime me Publikun* – gjejmë të publikuara lista të konsultimeve të zhvilluara në vite, të ndara me muaj, por ky informacion nuk është në format të hapur;
- ✓ *Lejet* – Në këtë rubrikë gjejmë të publikuara informacione si “Lista e aktiviteteve që kanë ndikim të lartë në ndotjen e mjedisit dhe në shëndetin”, “Regjistri i akt-miratimeve dhe akt-refuzime të Lejeve të Mjedisit të Tipit C” për çdo agjenci rajonale, “Subjektet e pajisura me Leje Mjedisit të Tipit C, që nuk kanë kryer monitorimet” etj., të cilat nuk janë në format të hapur dhe ky informacion është deri në vitin 2020;
- ✓ *Të dhënat për mjedisin* – Nuk ka asnjë informacion të publikuar nga Agjencitë rajonale.
- Menuja RRSHTN:
 - ✓ *e-PRTR* – (Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve) ofron informacion për periudhën 2014 – 2019 në formë tabelare dhe përditësim në hartë, por ky informacion nuk është në format të hapur dhe nuk mund të ripërdoret;
 - ✓ *PRTR* – nuk ofron informacion;
 - ✓ *Broshura PRTR* – Zëri i Komunitetit CSO, korrik 2024, në formatin pdf.
- Menuja “Inspektim Kontrolli” në nënrubrikat “Sektori i Inspektimit Mjedisor” dhe “Sektori i Monitorimit” nuk ka asnjë informacion të publikuar.
- Rubrika “Programi i Transparencës”, të dhënat për buxhetin dhe prokurimet janë të papërditësuara, si dhe jo gjithmonë në formate të hapura. Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike është në formatin xlsx, ndërsa regjistri i realizimeve dhe të dhënat për buxhetin janë në formate pdf.

Nga ky verifikim rezulton se AKM-ja me materialet dhe të dhënat që ka publikuar në rubrikat në faqen zyrtare nuk plotëson kërkesat e ligjit nr. 33/2022, të cituara në pikat 1 – 4, më lart.

5. Në faqen e Agjencisë nuk gjendet e publikuar logoja e licencës që përcakton kushtet e ripërdorimit, referuar detyrimeve të Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025 “Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”.

6. Nga verifikimi në portalin opendata.gov.al nuk konstatohen të dhëna apo dokumente të publikuara nga AKM-ja lidhur me veprimtarinë e saj.

Gjithashtu, referuar legjislacionit shqiptar, ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për publikimin e të dhënave të mbledhura apo krijuara nga AKM-ja, referuar fushës së veprimtarisë e përgjegjësisë, funksionojnë edhe faqet zyrtare <https://geoportal.asig.gov.al/>, e cila administrohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, si dhe faqja zyrtare <https://www.instat.gov.al/>, e cila administrohet nga Instituti i Statistikave.

Referuar faqes zyrtare <https://geoportal.asig.gov.al/>, ku publikohen të dhëna gjeohapësinore, rezulton se Agjencia Kombëtare e Mjedisit është identifikuar si autoritet përgjegjës për temën “Mbulesa e Tokës” me Vendimin nr. 22, datë 08.11.2016 “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”, Vendimin nr. 9, datë 05.04.2017 “Shpërndarja e specieve”, si dhe Vendimin nr. 11, datë 05.04.2017.

- ❖ Nga monitorimi i faqes zyrtare <https://geoportal.asig.gov.al/> rezultojnë të publikuar: Për temën “Mbulesa e Tokës”:

- ✓ Mbulesa e tokës (Corine 2012)
- ✓ Mbulesa e tokës Corine 2018

Në rubrikën Tema “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit”, të dhëna/*metadata* rezulton se janë publikuar të dhënat sipas listës së mëposhtme:

- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit fiziko-kimik të ujërave bregdetare 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetare, larës 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetare, larës 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetare, larës 2023
- ✓ Infrastruktura për monitorimin e mjedisit, Rrjeti i monitorimit mikrobiologjik të ujërave bregdetare, larës 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ajrit 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ajrit 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ajrit 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të cilësisë së tokës 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të erozionit 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të erozionit 2021

- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të lagunave, (Poligon) 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të lagunave (Pikë) 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të lagunave 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të lagunave 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ndotjes nga zhurmat 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ndotjes nga zhurmat 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ndotjes nga zhurmat urbane 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të pishës së zezë 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të pishës së zezë 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të specieve drunore në kërcënim 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave mikrobiologjike, larës 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave sipërfaqësore 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave sipërfaqësore 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2023;
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të liqeneve 2024;
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve, tributarët 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve, tributarët 2024

- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve, vetitë fiziko- kimike 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve (tributare) 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lumenjve për metalet e rënda 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2020
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2021
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të shkarkimeve 2024
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të ujërave të lagunave 2022
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane 2019
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane 2023
- ✓ Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit, Rrjeti i monitorimit të zhurmave urbane 2024

Publikimi i këtij informacioni është në format të hapur dhe i shoqëruar gjithashtu me *metadata*, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 33/2022.

Lidhur me temën “Shpërndarja e specieve”, miratuar me Vendimin nr. 11, datë 05.04.2017, nuk gjenden të dhëna të publikuara nga AKM-ja në gjeoportali.

- ❖ Nga monitorimi i faqes zyrtare <https://www.instat.gov.al/>, në rubrikën “Temat/Mjedisi dhe Energjia/Mjedisi”, rezultojnë të publikuara të dhëna statistikore si më poshtë:

- ✓ Ndotja bakteriologjike e ujit të detit në plazhe;
- ✓ Ndotja nga zhurmat në zonat e banuara;
- ✓ Përmbajtja e disa ndotësve atmosferikë në qytetet kryesore;
- ✓ Cilësia e ujit në lumenjtë e Shqipërisë.

Këto të dhëna janë të publikuara në formatet pdf dhe xlsx dhe si burim kanë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Gjithashtu, në rubrikën “Databaza statistikore”, në nënrubrikën “Mjedisi” rezultojnë të publikuara statistika për:

- ✓ Cilësia e ujit të lumenjve 2014 – 2024;
- ✓ Ndotja bakteriologjike e ujit të detit në plazhe 2012 – 2024;
- ✓ Ndotjet akustike në zonat urbane 2016 – 2024;
- ✓ Të dhëna fiziko-kimike të ujërave në liqenet e Shqipërisë 2004 – 2024.

Publikimi i këtij informacioni jo gjithmonë është në format të hapur dhe i shoqëruar me *metadata*, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 33/2022.

Referuar këtij procesi monitorimi dhe vlerësimi, bazuar në dokumentin “*Metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga Organet e Sektorit Publik dhe Sipërmarrjet Publike*”, rezulton një nivel “Përputhshmërie e ulët” e këtij organi të sektorit publik, në zbatimin e ligjit nr. 33/2022.

Ligji nr. 33/2022 përcakton se të dhënat e hapura nuk kanë vetëm funksion informues, por synojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ripërdorimin e informacionit të sektorit publik për qëllime ekonomike, sociale, kërkimore, inovative dhe zhvillimore.

Në këtë kuptim, publikimi i të dhënave në formate të hapura dhe të lexueshme nga kompjuteri synon krijimin e mundësisë që këto të dhëna të analizohen, përpunohen, kombinohen dhe ripërdoren nga aktorë të ndryshëm publikë dhe jopublikë, në funksion të zhvillimit të politikave të bazuara në evidencë, rritjes së transparencës dhe nxitjes së inovacionit digjital.

Në mënyrë të veçantë, të dhënat mjedisore përbëjnë kategori të të dhënave me vlerë të madhe (*high-value datasets*), sipas nenit 16 të ligjit nr. 33/2022 dhe standardeve të Direktivës (BE) 2019/1024, për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, kërkimin shkencor, monitorimin e ndotjes, menaxhimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e shërbimeve digjitale me interes publik.

Për rrjedhojë, mospublikimi i tyre në formate të hapura, të strukturuar dhe të ripërdorshme, në përputhje edhe me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 33/2022, kufizon ndjeshëm mundësinë e përdorimit efektiv të informacionit publik nga qytetarët, komuniteti akademik, organizatat e shoqërisë civile, media dhe sektori privat.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11, 12, 17 dhe 19 të ligjit nr. 33/2022,

REKOMANDOJ:

1. Organi i sektorit publik/Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në menunë kryesore të krijojë një rubrikë të dedikuar dhe të publikojë listën e dokumenteve dhe të dhënave që prodhon referuar veprimtarisë së saj, në zbatim të nenit 7, pika 3 e ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*. Në këtë listë të përfshihen edhe dokumente/të dhëna të publikuara nga ASIG dhe INSTAT, të cilat janë krijuar nga AKM-ja dhe të bëhet lidhja me publikimin.
2. Dokumentet e listuara në këtë listë të jenë në format të hapur/*open data*, të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me *metadata*-n. Po ashtu, edhe në rubrikën e menusë kryesore të krijuar në faqen zyrtare të AKM-së, përkatësisht “RRSHTN”, të publikohen dokumente/të dhëna, për të cilat AKM-ja është përgjegjëse, të jenë të aksesueshme, në zbatim të neneve 9 dhe 17 të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.
Gjithashtu, edhe dokumentet e publikuara në rubrikat e tjera, të cilat përmbajnë të dhëna mbi veprimtarinë e AKM-së, të publikohen në format të hapur, të lexueshëm nga kompjuteri.
3. Të vendoset në këtë rubrikë logo e licencës CC BY 4.0 për kushtet e ripërdorimit, referuar Udhëzimit të përbashkët të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 2, datë 6.2.2025 *“Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”*, e në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.
4. Dokumentet/të dhënat të publikohen edhe në portalin opendata.gov.al, me *metadata* dhe përditësim periodik, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*.
5. Në zbatim të nenit 18 dhe pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, detyrimet e përcaktuara në këtë Rekomandim të plotësohen brenda 90 ditëve nga data e marrjes dijeni.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 13.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi